

| | | |
|---|--|--|
|  | Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina |  PRISHTINA |
|---|--|--|

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

N.N.P "EURO CONSTRUCTION" (ne vazhdim "Kontraktori"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike kornizë për Punët e riparimit/mirëmbajtjes si në vijim:

Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e kulmeve në institucionet arsimore

| | |
|------------------------------------|--------------------------|
| Nr¹ i prokurimit | 616-19-2408-5-2-1 |
| Nr i brendshëm | 616 19 075 521 |

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e punëve të riparimit/mirëmbajtjes në vijim: **Rikonstruimin dhe mirëmbajtjen e kulmeve në institucionet arsimore**.

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Kontraktori, duke specifikuar listën e puneve qe duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendor në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë punë; të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me daten e nenshkrimit deri ne afat prej 12 muajve.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për ekzekutimin e punëve do të jetë 12 muaj.

2.2 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë Institucionet arsimore

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet e punëve riparuese janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Kontraktuesi.

Vlera totale indikative e kontratës është [74.445,00] Euro(Shtatëdhjetë e katërmijë e katërqind e dyzet e pesë euro). Devijimi i lejuar nga vlera totale indikative është [+,-30%]. Devijimi(+,- 30%) vlen edhe per cdo pozicion te paramasës dhe paralogarisë.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do tëjenë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë..

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga Autoriteti Kontraktues për punët e ekzekutuara ne baza mujore (ex post).

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit duke përfshirë Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetër; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.



Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjeter duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvëç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqimi, miratimi, certifikata apo vendimi do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhen **Shqipe** në tri originale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Kontraktuesin.

| Për Autoritetin Kontraktues | | Për Kontraktuesin | |
|-----------------------------|---|-------------------|---|
| Departamenti i Prokurimit | | | |
| Emri: | Zekë Bardhaj | Emri: | DEFRIM MORINA |
| Pozita: | Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit | Pozita: | AGENT I REGJISTRIMIT |
| Nënshkrimi: |  | Nënshkrimi: |  |
| Data: | | Data: | 29.07.2019 |
| Vula: |  | Vula: |  |

PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtuesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupei i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuqtojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruara dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontaktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkizati me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Obligimet e Autoritetit Kontraktues

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë ne dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe përkompensem dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit ne vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrate të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjate shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhërë apo ligjet anësore të Republikës se Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitive të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit përfamiljet e tyre.

Obligimet e Kontraktuesit

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrove administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu eksposuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe

do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informata e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grüpuit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 8.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standartet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe përmë tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritet nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren; dhe
- në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktivitetave në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësojë personel kyç dhe të përdorë pajisje të identifikuara në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhuar të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të **Certifikatës së Pranimit te Përkohshëm**.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- humbe ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- humbe ose dëmtim i Pajisjeve;
- humbe ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- dëmtim ose vdekje e personelit te tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuara.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsyё tё mjaftueshme dhe bindëse pёr zgjatjen e afatit tё ofrimit tё certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund tё zgjasë afatin e caktuar pёr dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose te eliminojë sigurimin dhe tё zgresë çmimin e shpérblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës se specifikuar ne KVK, kontraktuesi do tё i dorëzojë Menaxherit tё Projektit një program pёr miratim. Programi do te pёrmbaje se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punёve, afatin kohor qe kërkohet pёr dorëzim dhe miratim te vizatimeve, metodat e pёrgjithshme qe do ti zbatoje, dhe afatin kohor pёr secilin aktivitet tё specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit pёr me tepёr kërkon modifikime ne programin e punёve nё kuadër tё punёve tё kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njёherë programin dhe tia kthejë prapë Menaxherit tё projektit. Kontraktuesi do tё azhurnoj Programin nё intervalle jo më shumë se periudha e pёrçaktuar nё KVK.

12.3 Pёr çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje nё lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do tё sigurojë argument me shkrim Menaxherit tё Projektit.

12.4 Paraqitura e programit tё tillë, duke pёrfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do tё zvogëloj ose tё rriss detyrimet e kontraktuesit sipas punёve tё kontraktuara, si dhe çdo modifikim tё pёrfshirë nё programin e punimeve nuk do tё rezultojë nё ndonjë pagesë shtesë pёr kontraktuesin, nёse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë pёrpilimit tё programit.

Neni 13 Siguria nё vend-punishte

13.1 Kontraktuesi do tё ketë tё drejtёn tё ndaloj qasjen nё vend-punishte pёr çdo person i cili nuk eshtë i pёrfshirë nё zbatimin e kontratës, me pёrjashtim tё personave tё autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do tё sigurojë sigurinë nё vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do tё jetë pёrgjegjës pёr tё marrë hapat e nevojshëm, nё interes tё punonjësve tё tij, agjentëve te Autoritetit Kontraktues dhe palëve tё treta, pёr tё parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund tё rezultojë nga kryerja e punёve.

13.3 Kontraktuesi do tё marrë tё gjitha hapat e domosdoshme, pёr pёrgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, pёr tё siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahan. Ai do tё jetë pёrgjegjës pёr sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e siguri të cilat janë tё nevojshme pёr zbatimin e duhur tё detyrave ose që me arsyё mund tё kërkohen nga Autoriteti Kontraktues

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do tё sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun nё, lidhjet e komunikimit tё tilla si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, nё veçanti, do tё marrë parasysh kufizimet ne peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë te veçantë tё cilën Kontraktuesi e konsideron tё nevojshme, ose eshtë kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim tё mbrojtjes apo pёr tё pёrforuar pjesët e rrugëve, urave, do tё bartet ne shpenzime tё Kontraktuesit, pa marre parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet tё njoftojë Autoritetin kontraktues pёr çfarëdo masa tё veçanta që ai synon tё ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit te shkakuara nё rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do tё jetë nё shpenzime tё Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi eshtë pёrgjegjës pёr tё gjitha tatimet dhe detyrimet doganore nё pёrputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë pёrfshirë nё çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do tё harmonizojë çmimin e kontraktuar nёse konstaton se ka ngritur tё tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit tё tenderit dhe datës së fundit tё vërtetimit tё pёrfundimit tё punёve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do tё lejojë ndryshimin e çmimit tё kontraktuar pёr shkak tё ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore nё qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë nё vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punёve ose Materialeve që do tё pёrfshihen nё Punët nё mes tё Datës së fillimit dhe nё fund tё periudhës së Korrigjimit tё Defekteve do tё rregullohet nga Kontraktuesi nё koston e Kontraktuesit nёse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktori duhet të fillojë punimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

17.2 Kontraktuesi do të ekzekutoj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsyet:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka përqelli të bëjë kërkeshë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvèç nëse ka ndonjë marrëveshje tjeter ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit te detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do ti lejojë me shkrim Kontraktuesin këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospективë ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejtë për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njofitë zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zblesë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Konyraktuesit. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e kontraktuesit.

19.2 Nëse mosdorëzimi i punëve parandalon përdorimin e zakonshëm të punëve në tërsi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 19.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

14.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njofojë me shkrim Kontraktuesin:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të punëve. Kontraktuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Kontraktuesi i gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë përkompensim. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Materialet dhe mjeshtëritë

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përvëç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) kushtet e motit, ndërprerjet e punës qe detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhëne Kontraktuesit;
- b) deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave qe duhet bere Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune ne progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përsaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon qe të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marr një kopje të shënimive të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të janë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të janë objekt i një kërkese të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet ti referohet numrit te kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do te zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuara në kërkese duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në pune.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në pune ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në pune vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe përraportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet te dorëzohen në kohë në vend për ti lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do ti lejohet që të paraqesë ndonjë arsyë përvonesë në përm bushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishte ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do te miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes se mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlgimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimt do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të janë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimi.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se ai/ajo vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikkime teknike gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato ne skica apo ne specifikkim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët ne kontrate vlerësojnë se ndërrimet substanciale te punëve janë bere te nevojshme për shkak te gabimeve te tillë ose te përashtimeve te cilat substancialisht ndikojnë ne çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do te korrigojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit te Prokurimin Publik.

Neni 13 Korrigjimi i defekteve

13.1 Menaxheri i Projektit do të njoftoj Kontraktuesin mbi ndonjë defekt para përfundimit të periudhës garantuese të defekteve, e cila fillon në Përfundim. Kohëzgjatja e periudhës garantuese të defekteve është përcaktuar në KVK. Periudha garantuese e defekteve do te zgjatet deri sa te përmirësohen defektet.

13.2 Çdo here që epet njoftim mbi Defektet, Kontraktuesi do t'i korrigoj defektet brenda afatit kohor të specifikuar në njoftimin e Menaxherit të Projektit.

13.3 Kontraktuesi do t'i eliminojë defektet dhe do të arrrijë cilësinë e duhur të punës brenda kohës së caktuar nga Menaxheri i Projektit dhe kjo do të arrihet pa ndryshimin e çmimit të kontratës.

13.4 Në qoftë se Kontraktuesi nuk ndërmerr masa për të korriguar defektet e evidentuara nga Menaxheri i Projektit brenda afatit të caktuar, Menaxheri i Projektit do t'i vlerësojë defektet ose do të angazhojë një person të tretë për t'i eliminuar defektet.

13.5 Autoriteti Kontraktues do të kërkojë nga kontraktuesi kompensim ose do të kalkulojë shumën e vlerësuar në çmimin përfundimtar të kontratës.

PAGESAT

Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesave

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikatë. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhet interes për pagesë me

vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhen nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

24.5 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 24.2 kontraktori mund të informojë AQP-në për shkelje të tillë. AQPja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP

Neni 25 Paramasa dhe Parallogaria

25.1 Paramasa dhe parallogaria duhet të përbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve qe duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet përsasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Parallogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës pashallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përbaj aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret përmes monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregojë shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmoj se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim e tërë të Punëve. Kjo shume ne asnjë rast nuk do te tejkaloj 10% e vlerës totale te kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garacion bankar "me kërkesë".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës pashallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëj vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft te deklaratës se llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës se llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumen e cila sipas opinionit te tij duhet ti paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit te shumave te paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund te jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshoje te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumen përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Menaxheri i Projektit pa arsyё të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbytje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa tjera për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi te jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa te jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkeshës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm**.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përvëç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose t'i lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose t'i refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovimi.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendor, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund t'i:

- a) t'ë kryejë vetë pune, ose t'i punësojë dikë tjeter për kryerjen e punimeve, në rezik dhe kosto te Kontraktuesit, në të cilin rast kostojë e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga t'i dy; ose
- b) t'i ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurrit të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet t'i informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë se defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të janë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të e tij** sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të janë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe te jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tillë do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- (a) Kontraktuesi ndërprenë punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- (b) Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsyё të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të vonësës;
- (c) Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyjnë likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- (d) Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- (e) Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- (f) Kontraktuesi vonohet në përbushjen e punëve për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur cilado nga palët kontraktuese njofton Menaxherin e Projektit për shkelje të kontratës për arsyё të tjera nga ato të renditura më lart nën 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë a është shkelja thelbësore apo jo.

37.4 Nese pér shkak tē fajit tē palēs sē tretē krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon pérmbushjen e detyrimeve tē kontratës, Menaxheri i Projektit me pēlqimin e Kontraktuesit do tē pérfundoj vazhdimësinë e pérmbushjes sē punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do tē bëjë vlerësimin e punës sē kryer pjesërisht, do tē kërkohet nga kontraktuesi tē largohet nē momentin e martjes sē njoftimit me shkrim pér ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do tē ndërpres punën menjëherë, do tē siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga pérfundimi i periudhës sē njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet nē çregullimet industriale, çregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, kontrollit tē palëve kontraktuese.

38.2 Ne rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën tē pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësive tē parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me tē dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si nē vijim:

i. Obligimet dhe përgjegjësitet e kontraktuesit do tē pezullohen deri sa tē arrihet niveli i mundësisë objektive së pérmbushjes së tyre.

ii. Gjatë pezullimit dhe nē lidhje me punët e pezulluara, tē gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera tē ngashme i bart kontraktuesi.

iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritë nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit nē paguajë kontraktuesin.

iv. Afati pér pérmbushje tē obligimeve nga Kontraktuesi tē detyrimeve tē kontratës mund tē zgjatet edhe pér një periudhë pér aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.

v. Në qoftë se kontraktuesi pér një kohë tē gjatë është bërë i pa aftë, pér shkak tē Forcës Madhore, pér t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitet e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin pér

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nese kontrata ndërpritet pér shkak tē shkeljes materiale tē kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do tē lëshoi një çertifikatë mbi vlerën e punës së pérfunduar dhe materialet e porositura me më pak se përqindja e cila kërkohet nga vlera e punëve tē pérfunduara, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë tē likuidimit nuk do tē aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit tē Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do tē jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit

39.2 Nese kontrata ndërpritet pér shkak tē interesit tē Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë tē kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do tē lëshoj një certifikatë pér vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve.

Neni 40 Prona

40.1 Tē gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit nē vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do tē konsiderohen tē jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nese Kontrata ndërpritet pér shkak tē gabimit tē Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet pérmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do tē vërtetoj këtë. Kontraktuesi do tē siguroj vend punimin dhe do tē ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit tē këtij vërtetimi dhe do tē paguhet pér punët e kryera para pranimit tē tij dhe pér punët e kryera më pas pér tē cilat është arritur marrëveshje.

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë tē gjitha përpjekjet pér tē zgjidhur nē mënyrë miqësore tē gjitha mosmarrëveshjet që mund tē ndodhin ndërmjet tyre. Sapo tē shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetër me shkrim pér pozitën e tyre nē

mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës | | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK |
|---|-----------|--|
| Përshkrimi i nenit | Neni. Nr. | |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha | 2.1 | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë. |
| | 2.2 | Gjuha e përdorur do të jetë <i>shqipe</i> |
| Siguria e ekzekutimit | 10.1 | Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vleres se kontrates ne afat prej 13 muajsh |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 11.2 | <p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsy, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korrigon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkësave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjëri në koston e zëvendësimit të plotë; b. Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjafueshme për zëvendësimin e tyre; c. Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impanteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontraten shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. <p>g. Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjera: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar |
| Programi | 12.1 | Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 10 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës |
| | 12.2 | Periudha për Programin e azhurnuar është 10 ditë nga data e pranimit te kërkësës se Menaxherit te projektit. |

| | | |
|--|------|--|
| Fillimi i punëve dhe perfundimit | 17.1 | Data e Fillimit të fillimit të puneve do te ceket ne Planin e menagjimit te Kontrates, |
| Regjistri i punës | 20.1 | Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, |
| Inspektimi dhe testimi | 22.1 | Menaxheri i Projektit i caktuar me Vendim nga ZKA |
| Pagesat | 24 | Kërkesat për pageset do të bëhen punët e ekzekutuara në baza mujore (ex post). Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga Autoriteti Kontraktues për punët e ekzekutuara ne baza mujore (ex post). Nuk ka pageset paraprake |
| Parapagimi | 26.1 | N/A |
| Mbajtja e Parasë | 27.1 | Shuma e parave të mbajtura është: 10% e vlerës se kontratës |
| Shkaqet përkompensim | 30.1 | Data e posedimit të vend punimit do të përcaktohet nga menxheri i kontratës pasnënshkrimit të kontratës. |
| Përgjegjësia mbi Defektet | 34.5 | Periudha garantuese e defekteve është 365 ditë |
| Pagesa shkëputjes pas së kontratës | 39.1 | Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara. |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve | 42.2 | Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore | 43.1 | a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përherershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi. |

Paramasa dhe Prallogaria

"RIKONSTRUIMI DHE MIREMBASHTJA E KULMEVE-KONTRATË KORNIZË"

Përshkrimi i punëve.

Të gjitha punimet duhet te kryhen në perputhshmeri te plote me përshkrimin e punimeve dhe standartet EC e ISO.

Masat e sigurisë: Duhet të jene në nivelin më të lartë për arsyen e ruajtjes së shendetit të personave që punojnë dhe jetojnë asër punishtes. Vendosja e skeleve, rrethimi i punishtes, sigurimi i helmetave per punëtor dhe stafin mbikeqyrës, si dhe masat tjera mbrojtse sipas Ligjit për mbrojtje në punë dhe rregulloreve qe e rregullojne kete lemi. Materialjet nuk duhet të dalin jashtë rrethojes së punishtes. Për secilin pozicion ku janë përmendur karakteristikat teknike të prodhuesit mund të përdoren materiale me karakteristika të ngjashme të prodhuesve të ndryshëm në përpunë me standartet EC dhe ISO.

Punishtja të rrëthohet me tabela prej llamarine dhe me konstruksion të përforcuar mirë në toke.

Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parashev edhe çkyqjen e instalimeve eksistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikuqjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konzervimin te instalimeve egzistuese te cilat ngelen ne shërbim (funkcion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve.

| | VERJEJTJE: Te gjitha materialet e perdonura dhe te ekzekutuara duhet te deshmohen me ateste. Të gjitha pjesët e objektit që dëmtohen si proces i rikonstruimit ose mirembajtjes duhet të kthehet si ne gjendjen e para demtimit. | NJESIA | SASIA | ÇMIMI PER NJESI ME TVSH | ÇMIMI TOTAL ME TVSH |
|---|--|----------------|----------|-------------------------|---------------------|
| I Demolimet | | | | | |
| Per të gjitha pozicionet ne cmim duhet llogaritur edhe perdonimi i skelerive dhe mjeteve tjera per punë | | | | | |
| 1.1 | Demolimi i mbulesave ekzistues të kulmit nga (tjegullat, llamarina, azbest pllakat apo çfarëdo mbulese tjeter ekzistuese). | m ² | 2,500.00 | 0.5 | 1,250.00 |
| 1.2 | Demolimi i pjesës mbi konstruksion dhe nën mbulesë si: listelave drrasave, folijes difuzuve, izolimit dhe shtresave tjera ekzistuese mbi konstruksionin e kulmit. | m ² | 1,000.00 | 0.1 | 100.00 |
| 1.3 | Demolimi i ollukëve horizontale dhe vertikale. | m ¹ | 1,500.00 | 0.1 | 150.00 |
| 1.4 | Demolimi i shiritit të rrusepritësit me të gjitha pjesët e tij mbajtësit dhe lidhësit. | m ¹ | 250.00 | 0.1 | 25.00 |
| 1.5 | Demolimi i pengesave (mbrojtësve)të dëborës. | m ¹ | 150.00 | 0.1 | 15.00 |
| 1.5 | Demolimi i mbështjellësit të strehës si: llamperisë, dërrasa, plastifikë, dhe materiale tjera | m ² | 500.00 | 0.1 | 50.00 |
| 1.6 | Demolimi i mureve të kallkanit dhe ndonje muri tjeter ne kulëm duke perfshi te gjitha trashesit e murit. | m ² | 100 | 1 | 100.00 |
| 1.7 | Demolimi i oxhaqeve të demtuara | copë | 50 | 2 | 100.00 |
| 1.7 | Demolimi i konstruksionit të kulmit | m ² | 500 | 1 | 500.00 |
| | Gjithsejt punet e demolimit | | | | 2,290.00 |
| II Muratimet | | | | | |
| 2.1 | Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me trashësi 25cm me blloka giter ose blloka gaz betoni (siporeks) Ne cmim llogaritet edhe materiali lidhes dhe shpenzues per muratim | m ² | 150 | 15 | 2,250.00 |
| 2.2 | Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me trashësi 12 cm me blloka giter ose blloka gaz betoni (siporeks) Ne cmim llogaritet edhe materiali lidhes dhe shpenzues per muratim | m ² | 100 | 12 | 1,200.00 |
| 2.3 | Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me trashësi 25 & 12 cm me tulla. Ne cmim llogaritet edhe materiali lidhes dhe shpenzues per muratim | m ² | 100 | 10 | 1,000.00 |
| 2.4 | Furnizimi me material dhe punimi i mureve ndarese dhe plafoneve me pllaka gipsi me konstruksion metali që preferohet per ate lloji muri. Ne cmim duhet te llogariten edhe mbushja e konstruksionit me llesh mineral me trashesi 10 cm, vendosja e rrjetave ne vazhdimin e pllakave te gipesit, dhe materiali tjeter hargjuesi si bulona etj. | m ² | 300 | 12 | 3,600.00 |
| 2.5 | Furnizimi me material dhe muratimi kanaleve vertikale të oxhakut me elemente të oxhakut në llaq vazhdues 1:2:6. m ¹ | m ¹ | 60 | 5 | 300.00 |



| | | | | | |
|-----|---|----|------|-----|-----------|
| 2.6 | me dy shtresa izoluese. Me gjeresi fi-250-300 si shtrese te pare, dha blloka izolues 40/40 ose 45/45 cm. Ne emim duhet llogaritur edhe kapela mbi oxhak. | m1 | 25' | 50 | 1,250.00 |
| 2.7 | kostruktione te kulmit me tulla te argjilës në llaq vazhdues 1:2:6 sipas rregullave teknike. Në emim duhet llogaritur edhe perpunimi i kapeles se oxhakut, pshjellja me lesh guri me trashesi 5 cm dhe llamarin te plastifikuar me trashesi 0.6 mm (llamarina llogaritet per mbeshtjellje te oxhakut komplet mbi kalem dhe lidhje me konstruktion te kulmit | m1 | 25 | 20 | 500.00 |
| III | Gjithesejt punet e muratimi | | | | 10,100.00 |
| III | Punet e betonit te armuar | | | | |
| 3.1 | Furnizimi me material, transporti, përgatitja dhe betonimi të markës C-25/30 me përpunimin final per breza te kallkaneve dhe trajeve dhe shtyllave te nevojshme per konstrukzionin e kulmit. Armatura te përgatitet dhe te vendoset sipas planit te armaturës dhe llogarisë statike te prezantuar nga punekryesi dhe aprovuar nga mbikeqyresi. Në çmim te përfshihen kalllepët, si dhe te gjitha punët, përgatitjet paraprake dhe materialet e nevojshme se bashku me armaturë (sasia e armatures 60-100kg /m3 beton) | m³ | 120 | 50 | 6,000.00 |
| IV | Punimi i konstruksionit te kulmit | | | | 6,000.00 |
| 4.1 | Punimi i projektit per rikonstruimin e kulmit | m2 | 1000 | 0.5 | 500.00 |
| 4.2 | Furnizimi me material dhe punimi i konstruksionit te kulmit me materiali i drurit bredh i Kategorisë I me lagështi nen 18% me dimensione dhe elemente si ne projektin e punuar nga punekryesi dhe aprovuar nga menaxheri i kontrates. Ne emim duhet llogaritur te gjitha meterialet e nevojshme per konstruktimin e kulmit duke perfshire edhe gozhda, lidhese, bulona etj. Llogaritet ne sipërfaqe bazë e kulmit. | m2 | 120 | 20 | 2,400.00 |
| 4.3 | Furnizimi dhe vendosja e dyshemesë prej dërrasave apo paneleve OSB në gjithë sipërfaqen e kulmit (dërrasat duhet te jenë pa nyje dhe të rrashhta). Dërrasat apo OSB panelat te janë me trashësi minimum t=22mm, lagështi më te vogël se 18%. Ne emim duhet te meren parasysh te gjitha shpenzimet per ekzekutimin e ketij pozicioni. Llogaritet ne sipërfaqe mbuluese te kulmit (sipërfaqe e pjerret)në m² | m² | 1500 | 4 | 6,000.00 |
| 4.4 | Furnizimi me material dhe vendosja e Folja difuzivitetë përshtatshme për ventiluar kulmet. Membrana duhet te ketë forcëelasticitetipërafërsisht 450N / 5cm në gjatësi dhe gjërsi. Të kihet kujdes që mos te dëmtohet (shpohet apo shqyhet) gjatë instalimit në qoftë se ajo është dëmtuar rastësisht do te lejojë kalimin e lagështisë. Kjo folje membranëofron mbrojtjen e izolimit termik. Duke pasur një peshë te lartë për m². Detajet teknike Forca elastik 450N / 5cm (DIN EN 12311) i papërshkueshëm nga uji (DIN EN 13111), rezistencë termike - 40 ° C dhe + 80 ° . Llogaritet ne m² sipërfaqes mbuluese | m² | 1500 | 0.4 | 600.00 |
| 4.5 | Furnizimi me material dhe mbulimi i kulmit me kondor 3 mm si pjese e mbrojtjes se drrasave nga lageshtia | m2 | 150 | 0.4 | 60.00 |
| 4.6 | Furnizimi dhe vendosja e listellave në gjithë sipërfaqen e kulmit, lagështi më te vogël se 18% te pranishme në listela (listelat duhet te jenë pa nyje dhe të drejta). Listelat te kenë dimensione 80/50mm.m ¹ | m' | 1000 | 0.5 | 500.00 |
| 4.7 | Furnizimi dhe vendosja e listellave në në gjithë sipërfaqen e kulmit, lagështi më te vogël se 18% te pranishme në listela (listelat duhet te jenë pa nyje dhe të drejta). Listelat te kenë dimensione 50/30mm.m ¹ | m' | 300 | 1.2 | 360.00 |



| | | | | | |
|-----|---|----------------|----------|-----|-----------|
| | Furnizimi me material, pregaditja dhe punimi i mbuleses të kulmit me sendviç panelli- zjarrqendreuese, trashesi $t= 12$ cm. të valëzuarë të plastifikuar me ngjyre sipas kerkesë se menaxherit. Lamarinë mbi $t=0.6$ mm dhe nën - $t=0.5$ mm, koeficient i perqushmerisë se temperaturës $k=0.27$ $\text{W/m}^2\text{K}$, zaizolimi 26 dB. Pllakat vendosen mbi konstrukcionin e kulmit prej druri dhe mbi mbajesit sekondar të kapriata, sipas detajeve dhe udhëzimeve të prodhuesit të pllakave. Të kalkulohen tegjitha lidhjet, mbulesa e kurrit, lugut si dhe mbështjellja posht ollukut. Te parashifen dhe skelet perkratëse. | | | | |
| 4.8 | Llogarita në m^2 të mbulesës | m ² | 100 | 22 | 2,200.00 |
| | Gjithesejtë | | | | 12,620.00 |
| V | Mbulimi i kulmit | | | | |
| 5.1 | Furnizimi dhe vodosja e mbulesës së kulmit në objekt, mbulesa duhet të jetë llamarinë valëzuar (trapezoidal) e zinkuar dhe plastifikuar me $t=0.6$ mm dhe me brinje të valës min. 40mm. M^2 | m ² | 750.00 | 6.5 | 4,875.00 |
| 5.2 | Furnizimi dhe vodosja e mbulesës së kulmit në objekt, mbulesa duhet të jetë nga tjequllat e kl I-re me ngjyre sipas perzgjedhjes se menaxherit te kontrates. Ne cmim duhet llogaritur edhe prerja dhe vodosja e gozhdave | m ² | 1,700.00 | 12 | 20,400.00 |
| 5.3 | Furnizimi dhe vodosja e mbulesës së kulmit në objekt, mbulesa duhet të jetë llamarinë e rrafshët plastifikuar me $t=0.6$ mm dhe e punuar ne vend me lidhje (fâlce) Ne cmim duhet llogaritur të gjitha materialet shpenzuese per ekzekutimin e ketij pozicioni si dhe materialet dhe mjetet e nevojshme per ekzekutim. | m ² | 250.00 | 8 | 2,000.00 |
| 5.4 | Furnizimi me material dhe punimi i kulmarve të kulmit nga llamarina e plastifikuar me trashesi $t=0.6$ mm. Ne cmim duhen llogaritur edhe vodosja e bulonave special per kete pozicion me gomë të qendrueshme ndaj kushteve atmosferike. | m ¹ | 150.00 | 4 | 600.00 |
| 5.5 | Furnizimi me material dhe punimi i kulmarve të kulmit nga materiali argjilor - germuqet (kulmare) duhet te jen nga materiali dhe ngjyra e i njejt me tjequllat. Ne cmim duhet llogaritur edhe gozhdat qe duhet vodosur dhe materiali tjeter shpenzues. | m ¹ | 250.00 | 7 | 1,750.00 |
| 5.6 | Furnizimi dhe vodosja e mbrojtësit të borës për mos rrëshqitje nga llamarina e e plastifikuar me $t=0.6$ mm me gjatesi 100 cm . copë | copë | 150 | 1 | 150.00 |
| 5.7 | Furnizimi dhe vodosja e mbrojtësit të borës për mos rrëshqitje nga tjequllat. elementet duhet te jene te njojta me materialin e mbuleses dhe te pershtateshme per ate mbulese. llogaritet ne copë ne cmim duhet marr parasysh te gjitha shpenzimet dhe materialet e nevojshme per ekzekutimin e pozicionit | cope | 300 | 1 | 300.00 |
| 5.8 | Furnizimi me material,punimi dhe montimi ujëmbledhësit (ollukut) horizontal. Ujëmbledhësi të punohet nga llamarina e plastifikuar me trashesi $t=0.7$ mm dhe me gjërsë të shiritit deri ne $gs= 1.5$ m vazdimi i ujëmbledhësve të realizohet me "fallso" lidhje dhe shirit izolues/lidhës. Në këtë pozicion të përfshihen shtangimet e nevojshme. Llogaria në m^1 të ujëmbledhësit të vendosur. m^1 | m ¹ | 1100 | 4 | 4,400.00 |
| 5.9 | Furnizimi me material,punimi dhe montimi ujëmbledhësit (ollukut) vertikal. Ujëmbledhësi të punohet nga llamarina e plastifikuar me trashesi $t=0.60$ mm dhe me dimensione nga $\varnothing (150 - 200)$ mm. Ne këtë pozicion te përfshihet lidhja ne mes të ujëmbledhësit horizontal dhe atij vertikal me "hinke", gjithashtu shtangimi i ujëmbledhësve vertikal min. çdo 2.0 m. Llogaria ne m^1 te ujëmbledhësit të vendosur. m^1 | m ¹ | 850 | 4 | 3,400.00 |



| | | | | | |
|------|--|--------------|-----|------|-----------|
| | Furnizimi me material , punimi dhe montimi i elementit nga llamarina e plastifikuar në muret e kallkanit të objektit me trashësi $t= 0.7\text{mm}$ dhe gjerësi $gs= 660\text{mm}$. (atikes balloreve,kendoreve etj) vazhdimi i elementit të realizohet me lidhje "falso" dhe shirit izolues. Nëkëtë pozicion të përfshihen elementet për shtangim (hafterat) të nevojshme. Llogaria në m^1 të elementit të vendosur. m^1 | m^1 | 600 | 4 | 2,400.00 |
| 5.10 | Furnizimi me material, punimi dhe montimi i strehes nga llamarina e plastifikuar ose llamperi druri), ne cmim duhet llogaritur edhe mbajtesit e nevojshe'm si dhe bulonat me gome dhe materiali tjeter i nevojshem.Nese punohet nga llamperia e drurit ne cmim duhet llogaritur edhe ngjyrosja. | m^2 | 200 | 3 | 600.00 |
| 5.11 | Furnizimi me material, punimi dhe montimi i elementit nga llamarina e plastifikuar në ujëmbledhësin ne lugjet e kulmit dhe ujmledhesit horizontal me trashësi $t= 0.7\text{mm}$ dhe gjerësi $gs= 550 - 1000 \text{ mm}$, vazhdimi i elementit të realizohet me lidhje "falso" dhe shirit izolues. Nëkëtë pozicion tëpërfshihen elementet për shtangim (hafterat) të nevojshme. Llogaria në m^1 të elementit të vendosur." m^1 | m^1 | 200 | 7 | 1,400.00 |
| 5.12 | Furnizimi me material, punimi i mbulesës (Kapuçit) të oxhakut me elemente të parafabrikuara (adequate). Në llogari të përfshihet ngjyrosja me njyrë rezistuese ndaj zjarrit. Llogaritja në copë të mbulesës së vendosur. copë | copë | 20 | 20 | 400.00 |
| 5.13 | Furnizimi me material ,punimi i mbështjelljes se oxhakut të me llamarinë të plstifikuar në kontakt me kulmin. Llogaritja në copë. Copë | copë | 20 | 20 | 400.00 |
| 5.14 | Furnizimi me mataerial dhe vendosja e bulonave të ri me gom adekuate per asnjn lloj kulmi dhe rezistente ndaj kushteve atmosferike se paku 5 vjet. Ne cmim duhet llogaritur te gjitha shpenzimet qe nevoiten per montimin e tyre. | copë | 500 | 0.05 | 25.00 |
| 5.15 | Riparimi i llamarines se demtuar me poliuretan pas vendosjes se silikonit ngjites dhe izolues. Ne cmim duhet llogaritur te gjitha shpenzimet dhe materialet e nevojshme per realizimin e ketij pozicioni. Llogarohet ne cope | copë | 300 | 1 | 300.00 |
| 5.16 | | | | | 43,400.00 |
| VI | IZOLIMET E KULMEVE TE RRAFSHETA | | | | |
| 6.1 | Analizimi i problemit dhe pergaftja e terenit per izolim te kulmit. Ne cmim duhet te llogaritet shqyrtimi, largimi i materialeve ekzistuese, materialit mbrojtës etj si dhe kthimi i materialit mbrojtës pas perfundimit te izolimit. | m^2 | 80 | 2 | 160.00 |
| 6.2 | Furnizimi me material, punimi i nivelizimit te kulmit me qellim te dhenjes se shtreses izoluese. Ne cmim duhet te llogariten te gjitha shpenzimet e materialit dhe veglat e punes per ekzekutimin e ketij pozicioni. Trashesia e nivelizimit me fibra nga ($t=3 \text{ cm}$ deri $t=6 \text{ cm}$) | m^2 | 80 | 6 | 480.00 |
| 6.3 | Furnizimi me material dhe punimi i izolimit me kondor $t=4 \text{ mm}$ ne dy shtresa . Ne cmim duhet te llogaritet edhe birtuliti i cili duhet te ekzekutohet para fillimit te vendosjes se shtresave si dhe te gjithashpenzimet e materialit tjeter te nevojshem per ekzekutimin e pozicionit. | m^2 | 80 | 5 | 400.00 |
| VII | Instalimet Elektrike | | | | 1,040.00 |
| | Përdorimi i materialeve adekuate është thelbësor për një instalim të mirë dhe të sigurt.Çdo material elektrik duhet të jetë i certifikuar dhe me prejardhje të njohur.E rëndësishme është edhe realizimi i punimeve elektrike gjithnjë duke ju besuar kontraktorëve të licencuar. Në të gjitha pozicionet në çmim të llogariten edhe furnizimi dhe montimi i materialit të imët i paspecifikuar. | | | | |
| 7.1 | Demolimi i shiritit ekzistues perpunimi dhe montimi i shiritit prap ne poziten e nevojshme te kulmit. Ne cmim duhet te llogariten edhe plakat lidhese dhe mbajtesit e nevojshem per montimin e te njejtës. | m^1 | 200 | 0.1 | 20.00 |



| | | | | | |
|---------------------|---|----------------|-----|-----|-----------|
| 7.2 | Furnizimi i prerja dhe montimi i shiritit FeZn 25x4mm2 në kufimet e objektit. Ne emim duhet llogaritur pllaka me bulona te nevojshem per lidhje si dhe mbajtjet e nevojshem per lidhje me kulem dhe testimi i rrufepritesit. | m ² | 200 | 0.5 | 100.00 |
| 7.3 | Matja e pikave matëse dhe dorëzimi i atesteve investitorit. copë | copë | 10 | 5 | 50.00 |
| | | | | | 170.00 |
| 8 | Suvatimi | | | | |
| 8.1 | Furnizimi me material suvatimi i mureve dhe tavaneve. Në çmim të llogaritet edhe punimi i këndoreve metalike në kënde te cdo kend dhe furnizimi dhe vendosja e rrjetës RABIC përgjatë trajeve dhe shtyllave që janë të lidhura me muret ndarëse. Rrjeta duhet të vendoset gjatë fazës së suvatimit Sipërsaqja e fituar nuk është mjaft e rrashët. Mund të lihet e tillë me një strukturë apo për rrashim adekuat rrashohet edhe me një shtresë patinim-glet. Materialet tjera për suvatim janë materiale të gatshme nga prodhues të ndryshëm me bazë gipsi që përzihet me ujë me makina automatike dhe spërkatje. Sipërsaqet e krijuara janë mjaftë të rrashëta dhe të pranueshme por përrashim të përkryer nevojitet edhe një shtresë e hollë patinuese. | m ² | 500 | 3 | 1,500.00 |
| 8.2 | Furnizimi me material dhe ngjyrosja e objekteve me ngjyre te kualitetit te larte, me dy shtresa ngjyre, ngjyra e percaktuar sipas projektit ose organit kompetent. | m ² | 500 | 0.6 | 300.00 |
| 8.3 | Furnizimi me material dhe lyerja me beton kontakt ne muret e betonarmes dhe shtresat e demtuara dhe te rezikuara nga lagështia dhe shkëputja para vendosjes se gletitose ngjyrosjes. | m ² | 50 | 0.5 | 25.00 |
| | | | | | 1,825.00 |
| REKAPITULIMI | | | | | |
| I | Demolimet | | | | 2,290.00 |
| II | Muratimet | | | | 10,100.00 |
| III | Punet e betonit te armuar | | | | 6,000.00 |
| IV | Punimi i konstruktionsit te kulmit | | | | 12,620.00 |
| V | Mbulimi i kulmit | | | | 43,400.00 |
| VI | IZOLIMET E KULMEVE TE RRAFSHETA | | | | 1,040.00 |
| VII | Instalimet Elektrike | | | | 170.00 |
| VII | Suvatimi | | | | 1,825.00 |
| | GJITHESEJTE | | | | 77,445.00 |

